



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE

ANALIZË

PROCESI I BUXHETIMIT NË KOMUNA

- Qytetarët afër apo larg -

PRILL 2023

Ky aktivitet realizohet në kuadrin e projektit 'Dialogue for European Municipalities' (DEM), i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë.



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Përmbajtja:

Hyrje	3
Metodologjia.....	5
Përshkrimi i Përgjithshëm	6
Prioritetizimi i Investimeve Kapitale	8
Plani i zbatimeve të Rekomandimeve Vjetore të Auditorit 2020	11
Plani i zbatimeve të Rekomandimeve Vjetore të Auditorit 2021	12
Kapacitetet Planifikuese/Fondet Zhvillimore:	12
Obligimet e Komunave në Procesin e Konsultimit Publik.....	16
Konkluzione:	27
Rekomandime:	28

Nga procesi i analizës “**Procesi i Buxhetimit në Komuna – qytetarët afër apo larg**”, dalin katër probleme kyçe: e para, mungesa e pronësisë së publikut në proceset buxhetore; e dyta, mungesa e planifikimit strategjik dhe të integruar; e treta, paqartësitë në zbatimin e mandateve; si dhe e katërta, procesi formal i vlerësimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjikor (BPGj). Ekziston nevoja, që: i. të standardizohen format, si dhe mjetet e publikimit; ii. të avancohen kapacitetet dhe praktikat në proceset e prioritizimit; iii. të ndërtohen/konsolidohen sisteme të integruara të planifikimit; iv. të zgjerohet niveli i konsultimeve si dhe konstituohen mekanizmat komunalë; v. të qartësohen mandatet dhe detyrat e organeve komunale (ekzekutivit dhe legjislativit) si dhe vi. të përdoret qasje ndërthurëse në politika, procese dhe strategji komunale.

Në ueb faqet e komunave, qasja për materialet e punës së Kuvendeve Komunale mbetet kaotike, nuk ka ndonjë strukturë uniforme, përderisa edhe tek komunat që publikojnë materialet e punës (propozim buxhetet), nuk ekziston ndonjë format i standardizuar i publikimit. Rekomandohet të ndërtohen forma standarde, nëpërmjet një manuali për proceset buxhetore, si dhe strukturë uniforme për publikim në ueb faqe. Përkundër që Udhëzimi Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Investimeve Kapitale, nxjerr obligime të qarta për komunat dhe për dy vite radhazi (2020 dhe 2021) vendoset në thekset e auditorit, shumica nuk i përmbushin obligimet. Rekomandohet të rritet informimi dhe të ngritën kapacitetet për prioritizimin e investimeve kapitale bazuar në shtojcën e udhëzimit administrativ. Po ashtu, Kuvendet Komunale të rrisin kërkesën për llogaridhënie për proceset e vlerësimit dhe poentimit sipas kriterëve.

Ka mangësi të theksuara tek procesi i programimit, si rrjedhojë e problemeve që dalin nga identifikimi i qartë i nevojave, analiza ndërthurëse si dhe ndjekja e strategjive zhvillimore komunale dhe nacionale. Për rrjedhojë ndodh fragmentimi i politikave dhe investimeve si dhe humbet potenciali për aplikime në fonde zhvillimore rajonale dhe IPA. Rekomandohet të ndërtohen struktura kompakte dhe sisteme të integruara për identifikim, analizë, prioritizim, projektim të proceseve kyçe komunale, ndërlidhje me strategjitë, politikat dokumentet zhvillimore lokale dhe nacionale si dhe aplikime në nisma dhe fonde zhvillimore. Përderisa, procesi i konsultimit të buxheteve komunale ka mangësi të theksuara nisur nga mbledhja e kërkesave, trajtimit, adresimi dhe deri tek publikimi; si rezultat raporti i auditorit thekson se komunat e audituara ende nuk kishin procese standarde të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimin e tyre dhe prioritizimin e nevojave për investim. Rekomandohet të ndërtohet harta e proceseve kyçe konsultative buxhetore si dhe të standardizohet procesi nga pranimi i kërkesës deri tek aprovimi dhe publikimi në platformat komunale.

Ndërkaq, mbetet sfiduese shtrirja/zgjerimi i diskutimeve në qendra/fshatra, për rrjedhojë mungon edhe një shpërndarje e drejtë dhe e barabartë e investimeve publike. Po ashtu, edhe tek përfshirja e publikut, në veçanti grupeve të veçanta, dalin mangësi të theksuara, si rrjedhojë e kësaj shpesh investimet publike, nuk marrin parasysh ndjeshmërinë ndaj tyre, në veçanti grave, personave me aftësi të kufizuara, minoriteteve dhe grupeve të cenueshme. Reflektohet përqindje e ulët e

pjesëmarrjes së grave në dëgjime buxhetore. Rekomandohet të konsolidohen mekanizmat komunalë për zgjerim të konsultimit dhe kontribute profesionale (këshillat lokalë, komitetet konsultative) dhe të popullohen të dhënat për grupet e interesit; Të ndërtohen/konsolidohen platforma dhe agjenda komunale për bashkë-dizajnim të politikave me përfshirjen e publikut si dhe fokus grupeve; Të përdoret qasje ndërthurëse në politika, procese dhe financime të çështjeve që prekin grupet e veçanta si, gratë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe grupet e cenuara. Të shtohet fokusi tek rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e dëgjimeve buxhetore, duke përgatitur plane të veçanta të informimit dhe përfshirjes.

Ekzistojnë paqartësi dhe kahe të kundërta në zbatimin e mandateve për proceset buxhetore komunale, përderisa ekzekutivi nuk ka krijuar procese standarde të pranimit, shqyrtimit dhe prioritizimit të nevojave për investime, por që kryen detyrat e Kuvendeve Komunale për dëgjime buxhetore; përderisa anëtarët e Kuvendeve Komunale, nuk zbatojnë mandatin udhëheqës për proceset e konsultimeve dhe mbikëqyrës për prioritizim të investimeve. Rekomandohet të definohen qartë mandatet dhe funksionet në mes ekzekutivit dhe kuvendit; Të avancohet niveli profesional i prioritizimit të investimeve kapitale, nga ekzekutivi; Të ushtrohet mandati i kuvendeve komunale mbi përgjegjësitë dhe atributet kryesore në miratimin e buxhetit; si dhe të forcohet roli i mbikëqyrjes mbi ekzekutivin. Një problem sistematik, që për rrjedhojë rritë presionin në qendër, është mungesa e një hartëzimi të qartë të rrugës së kërkesës së qytetarëve, nisur nga kërkesa, analizimi, prioritizimi, konsultimi si dhe pasqyrimi në detaje. E shtyrë edhe nga mungesa e mekanizmave të konsoliduar si këshillat lokalë, Komitetet Konsultative dhe përfshirja e fokus grupeve, shpesh ulë nivelin e besueshmërisë në strukturën e procesit dhe shton presionin për drejtoritë dhe ekzekutivin. Rekomandohet të ulet tollovia në qendër duke shtrirë mekanizmat përfaqësues si dhe duke hapur mundësitë që dikasteret komunale të rrisin rolin programues, menaxhues dhe monitorues.

Për më tepër, kjo bëhet edhe më sfiduese në adresimin e problemeve të ndër-varura (*trafo-rrjet elektrik, ujësjellës-kanalizim, menaxhim i shtatoreve dhe varrezave, trotuare në rrugë magjistrale, mbikalimet-siguria në hekurudha, pronat e agjencive/nivelit qendror, afati i legalizimit*). Ndërkaq, në adresimin e problemeve të ndër-varura rekomandohet të konsolidohet sistemi i komunikimit, prioritizimit dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve rajonale, qendrore, agjencive dhe nivelit qendror.

Dokumenti ka këtë shtrirje: prioritizimi i investimeve kapitale, kapacitetet planifikuese dhe zhvillimore, proceset konsultative, mandatet e organeve komunale, formati i dëgjimeve buxhetore, prioritetet e dala nga dëgjimet buxhetore si dhe konkluzionet dhe rekomandimet.

Metodologjia

Në procesin e analizës, janë përdorur tri qasje: i. obligimet e komunave në procesin e buxhetit; ii. vlerësimet/raportet periodike nga institucionet dhe shoqëria civile dhe iii. qasja ndërthurëse në mes obligimeve dhe përbushjes nga komunat.

- *Ligji për Vetëqeverisje Lokale – Udhëzimi Administrativ për Transparencë në Komuna; Udhëzimi Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik;*
- *Ligji për Financat e Pushtetit Lokal; Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (afatet, obligimet dhe procedurat e miratimit të buxhetit); Udhëzimi Administrativë për Kriteret Përzgjedhëse të Investimeve Kapitale;*
- *Raporti i Vjetor i Auditimit 2021; Raporti Vjetor i Performancës 2021;*
- *Raporti Financiar për vitin 2021 dhe 2022 (thesari);*
- *Qarkorja Buxhetore 2023/02 për Komuna;*
- *Raporti i Përbushjes së Obligimeve nga Agjenda Evropiane (janar-qershor) 2022;*
- *Raporti për Vlerësimin e Transaprencës (janar-dhjetor) 2022*

Përgjatë periudhës (06–20) prill, 2023 në Ueb faqet e Komunave janë nxjerr këto të dhëna: publikimi i raporteve nga konsultimet publike; buxhetet komunale; ftesat dhe materialet e punës së Kuvendeve Komunale dhe raportet financiare (2021-2022). Nga Platforma e e-Konsultimeve janë nxjerrë proceset konsultative për buxhetin vjetor 2023.

- *Në materialet e punës së kuvendeve: të dhënat për shtojcën e konsultimit publik si dhe shtojcën e vlerësimit të prioritizimit të projekteve kapitale;*
- *Në ftesa: data e thirrjes për Kuvendet Komunale, për mbledhjen e miratimit të buxhetit vjetor 2023;*
- *Nga raportet e konsultimit: kush ka udhëhequr procesin, numri i konsultimeve (me/pa komente), lloji/shtrirja, çështjet kyçe të adresuara, numri i pjesëmarrësve (burra/gra), a kanë qenë të përfshira kërkesat e regjistruara nga qytetarët në zyrat pritëse.*
- *Nga buxhetet komunale: përshkrimi i investimeve në detaje, Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjikor (BPGj).*

Të dhëna nga Zyrat për Informim: informacione për zyrën/ekipin për projekte zhvillimore; strukturën/varësinë, numrin dhe statusin.

Shtojca: të dhënat për llojin e donacioneve (donatorë të jashtëm, brendshëm dhe participime); detajet lidhur me kërkesat nga dëgjimet buxhetore.

Koment/vërejtje: Të gjitha të dhënat e nxjerra nga ueb-faqet e komunave janë kërkuar në kategoritë e përcaktuara por edhe në shfletime të rubrikave. Në rast se nuk është paraqitur ndonjë e dhënë nënkupton se nuk është arritur të gjendet në ueb-faqe, por kjo nuk nënkupton domosdo se komunës i mungojnë këto të dhëna.

Përshkrimi i Përgjithshëm

Nga tridhjetë e tetë (38) ueb faqet e komunave, në njëzet e gjashtë (26), nuk është gjetur materiali i punës për mbledhjet e Kuvendeve Komunale, në dhjetë (10) komuna është gjetur materiali për mbledhjen e miratimit të buxhetit, ndërkaq në tri (3) publikohen materialet, por nuk u gjet ai për mbledhjen e miratimit të buxhetit. Vetëm në një (1) nga dhjetë (10) komunat që kanë paraqitur bashkë me materialin e punës së Kuvendit Komunal, në Propozim Buxhetin e Vitit 2023, është gjetur shtojca e vlerësimit të projekteve të propozuara për aprovim në Kuvendet Komunale, të përcaktuar në nenin 4, pika 8 e Udhëzimit Administrativ për Kriteret përzgjedhëse të Projekteve Kapitale.

Përderisa, sa i përket të dhënave lidhur me funksionimin e ekipeve/zyrave të aplikimit në projekte, referuar të dhënave të siguruara nga Zyrat për Informim, del se asnjëra nga njëzetetë (28) komunat që janë siguruar të dhëna, komunat nuk kanë të themeluara apo funksionale si të veçanta këto ekipe/zyra. Në shumicën prej komunave, kjo detyrë ushtrohet nga zyrtarë komunalë, brenda drejtorive, apo edhe Zyrës së Kryetarit.

Për të parë se sa kanë përfituar komunat nga grantet, Instituti KLGJ ka nxjerrë të dhëna nga raportet financiare të publikuara nga komunat në vitin 2021 dhe 2022, duke lidhur linqet e raporteve si dhe shumat e donacioneve. Përtej financimit të alokuar në Grantin e Performancës Komunale, që disbursohet në bazë të rezultateve në Raportin e Performancës Komunale, nga raportet financiare 2021 dhe 2022, del se pjesën më të madhe të donacioneve në komuna e përbëjnë donatorët e brendshëm dhe participimet.

Referuar tabelës së konsultimeve publike për proceset buxhetore del se, vetëm tri (3) komuna kanë vendosur buxhetin në platformën e konsultimit publik, ndërkaq një (1) komunë ka vendosur qarkoren dhe një (1) komunë vetëm njoftimin. Njëzet (20) komuna kanë publikuar raportet nga konsultimet e dëgjimeve buxhetore, ndërkaq vetëm dhjetë (10) komuna kanë publikuar raportin me komente (pranohet/pjesërisht/refuzohet), një (1) komunë ka paraqitur komentet pjesërisht.

Referuar tabelës së komunave sipas numrit të dëgjimeve buxhetore, llojit/targetit dhe numrit të pjesëmarrësve, del se nga njëzet e dy (22) që kanë paraqitur informacione për konsultime, dy (2) prej tyre kanë pasur vetëm njoftime. Nga njëzet (20) raportet e paraqitura, katër (4) komuna kanë mbajtur dëgjime buxhetore të përgjithshme, gjashtë komuna (6) kanë mbajtur tri (3) targete/lloje të dëgjimeve (zona/fshatra, institucione/sectorë dhe fokus grupe) - një (1) prej tyre ka mbajtur takim me (subjektet politike), tetë (8) komuna kanë mbajtur dëgjime buxhetore me nga dy (2) target/lloje (qendra/fshatra). Trembëdhjetë (13) nga njëzet e dy (22) komuna kanë ndarë pjesëmarrësit (burra/gra), ku del se përqindja e pjesëmarrjes në dëgjime është 77.41% (burra) dhe vetëm 22.59% (gra).

Edhe pse Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përkatësisht neni 61, pika 61.2 e këtij ligji, obligon kuvendet komunale që pas pranimit të projekt buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime buxhetore. Referuar raporteve të paraqitura, në vetëm pesë (5) procese ka

udhëhequr Kryesuesi i Kuvendit, apo Zyra e Kuvendit Komunal, në pesë (5) raste takimi është udhëhequr nga Drejtorët e Financave, në gjashtë (6) raste grupi punues, në një (1) rast zyrtari për konsultim dhe në tri (3) raste nuk ka detaje. Por, duhet theksuar se në shumicën prej rasteve kur ka pasur grup punues, nuk ka përfshirje nga anëtarët e Kuvendeve Komunale.

Në asnjë prej njëzet (20) komunave që kanë paraqitur raporte, nuk ka ndonjë praktikë ku prezantohen ndarje specifike sipas zonave/fshatrave, apo edhe në bazë të target grupeve. Po ashtu, nuk ka raste, kur në proceset e dëgjimeve, bashkëngjitet listë me kërkesa të protokolluara në zyrat pritëse komunale. Nga tridhjetë e një (31) komuna që kanë publikimet e buxheteve komunale, del se vetëm pesë (5) kanë bashkëngjitur shtojcën e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjikor (BPGj). Po ashtu, edhe tek paraqitja në detaje e investimeve kapitale, del se vetëm njëzet e tri (23) komuna kanë shënime për lagjen, fshatin apo edhe shkollën ku do të kryhen investimet publike.

Në njëmbëdhjetë (11) komuna janë adresuar çështje/probleme të ndër-varura si: *trafo-rrjet elektrik, ujësjellës-kanalizim, menaxhim i shtatoreve dhe varrezave, trotuare në rrugë magjistrale, mbikalimet-siguria në hekurudha, pronat e agjencive/nivelit qendror dhe afati i legalizimit.*

Prioritetizimi i Investimeve Kapitale

Raporti Vjetor Financiar 2021 i Auditorit të Përgjithshëm thekson se 'Planifikimi i projekteve në Programin për Investime Publike (PIP) duhet të bëhet në mënyrë të detajuar dhe të aprovohet nga krerët e organizatave, bazuar në analizat dhe arsyeshmërinë e tyre'¹. Rezultatet e auditimit kanë nxjerr në pah se komunat e audituara ende nuk kishin procese standarde të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimin e tyre dhe prioritetizimin e nevojave për investim². Në monitorimin e implementimit të projekteve nga Granti i Performancës, theksohet se gjysma e projekteve të audituara nuk ishin realizuar me kohë dhe nuk janë në shfrytëzim të plotë nga qytetarët³. Çështjet e identifikuara gjatë auditimit tregojnë se ekziston nevoja për përmirësime në procesin e menaxhimit të këtyre projekteve. Referuar raportit të Thesarit për shpenzimet 31 dhjetor 2022⁴, del se katër (4) komuna kanë mbetur nën 50% të shpenzimeve të investimeve kapitale. Ndërkaq, katërbëdhjetë (14) komuna kanë shpenzuar më pak se 75% të buxhetit për investime kapitale. Ky është edhe njëri nga kriteret kualifikuese për grantin e performancës komunave.

Obligimet e Komunave në Prioritetizimin e Investimeve Kapitale

Referuar Udhëzimit Administrativ MF- Nr. 06/2019 Për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projekteve Kapitale - **nenit 4 Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të propozim-projektit kapital** nga organizata buxhetore, në pikën 1. Procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të propozim-projektit kapital sipas kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ bëhet nga çdo organizatë buxhetore për çdo projekt të propozuar me vlerë totale të projektit tridhjetë mijë (30,000 €) euro ose më shumë.

Sipas nenit 4, procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të propozim-projektit kapital nga organizata buxhetore, **pika 8, çdo projekt i propozuar nga Komuna për aprovim nga Kuvendi i Komunës duhet të ketë të bashkëngjitur vlerësimin sipas kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ; pika 3, përveç zbatimit të kërkesave sipas paragrafit 2 të këtij neni, çdo organizatë buxhetore duhet të plotësojë të gjitha të dhënat e kërkuara në sistemin e Programit të Investimeve Publike (këtu e tutje PIP) për çdo projekt kapital të propozuar sipas kërkesave dhe procedurave të parapara me manualin e paraqitur në shtojcën 2 të këtij Udhëzimi Administrativ; pika 4, Vlerësimi dhe notimi i propozim-projektit mund të bëhet deri në treqind (300) pikë. Organizata buxhetore mund të propozojë për **aprovim** në Ligjin e Buxhetit projektet që marrin më së shumti pikë sipas kriterëve të këtij Udhëzimi Administrativ dhe në përputhje me mundësitë buxhetore.**

Për të rritur nivelin e planifikimit të Investimeve Kapitale, ministria përkatëse ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për **Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projektit Kapital**, i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2020⁵. Nga tridhjetë e tetë (38) ueb faqet e komunave, në njëzet e pesë (25), nuk është gjetur materiali i punës për mbledhjet e Kuvendeve Komunale, në dhjetë (10) komuna është gjetur

¹ https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/08/RaportiVjetoriAuditimit_2021_Shqip-2.pdf


² https://zka-rks.org/wp-content/uploads/2022/04/ZKA_RVP_2021_Shqip.pdf

³ Po aty


⁴ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/F16EFD6E-6324-4031-A1E8-3E1FCA6A3F22.pdf>

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21946>

materiali për mbledhjen e miratimit të buxhetit, ndërkaq në tri (3) publikohen materialet, por nuk u gjet ai për mbledhjen e miratimit të buxhetit



Megjithatë, vetëm në një (1) nga dhjetë (10) komunitat që kanë paraqitur bashkë me materialin e punës së Kuvendit Komunal, në Propozim Buxhetin e Vitit 2023, është gjetur shtojca e vlerësimit të projekteve të propozuara për aprovim në Kuvendet Komunale, të përcaktuar në nenin 4, pika 8 e këtij Udhëzimi Administrativ⁶.



Baza ligjore për hartimin e Udhëzimit Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projektit Kapital, i referohet nenit 21 dhe 23 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i Plotësuar dhe Ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007 në Republikën e Kosovës, dhe ka për qëllim, shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt-propozimit kapital nga çdo organizatë buxhetore gjatë përgatitjes së tij. Qarkorja Buxhetore 2023/02⁷ për komunitat në pikën 2, tek kriteret e përgjithshme dhe specifike për përgatitjen e buxhetit, thekson se nëse komunitat nuk plotësojnë të dhënat sipas manualit të PIP dhe analizën për çdo projekt-propozim të ri sipas Udhëzimit Administrativ për kriteret përzgjedhëse, si dhe nëse dorëzohet propozim buxheti që

⁶ Po aty

⁷ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/34B3C388-1DEC-44E4-B9A6-8CA70E317EC7.pdf>

përmban keq-klasifikim, atëherë Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) do të marrë masa për korrigjimin e tyre para dorëzimit të projekt-buxhetit për vitin 2023 për aprovim në Qeveri⁸.

Tabela 1. Sipas komunave paraqet publikimin në ueb faqe materialin e punës së kuvendit si dhe paraqitjen e shtojcës për vlerësim sipas kriterëve të prioritetizimit të investimeve, si dhe poentizimi deri 300 pikë.

Nr.	Komuna	Materiali i punës së Kuvendit Komunal në ueb faqe/data	Prioritetizimi i investimeve kapitale	Poentimi deri 300 pikë
1	Obiliq	Nuk ka rubrikë		
2	Podujevë	Nuk ka të dhëna		
3	Prishtinë	Nuk ka rubrikë		
4	Shtime	Nuk ka rubrikë		
5	Graçanicë	Nuk ka rubrikë		
6	Dragash	Nuk ka rubrikë		
7	Prizren	PO	JO	JO
8	Rahovec	PO	PO	PO
9	Klinë	Nuk ka të dhëna		
10	Pejë	PO	JO	JO
11	Junik	PO	JO	JO
12	Kaçanik	Nuk ka rubrikë		
13	Kamenicë	Nuk ka rubrikë		
14	Shtërpcë	Nuk ka rubrikë		
15	Novobërdë	Nuk ka rubrikë		
16	Glllogoc	PO	JO	JO
17	Fushë-Kosovë	Nuk ka rubrikë		
18	Lipjan	PO	JO	JO
19	Suharekë	Nuk ka rubrikë		
20	Malishevë	Nuk ka rubrikë		
21	Mamushë	PO	JO	JO
22	Deçan	Nuk ka rubrikë		
23	Gjakovë	Nuk ka rubrikë		
24	Istog	PO	JO	JO
25	Leposaviq	Nuk ka rubrikë		
26	Mitrovicë e Jugut	Nuk ka rubrikë		

⁸ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/34B3C388-1DEC-44E4-B9A6-8CA70E317EC7.pdf>

27	Skenderaj	Nuk ka rubrikë		
28	Vushtrri	<u>PO</u>	JO	JO
29	Zubin Potok	Nuk ka rubrikë		
30	Zveçan	Nuk ka rubrikë		
31	Mitrovicë e Veriut	Nuk ka rubrikë		
32	Gjilan	<u>Nuk ka të dhëna</u>		
33	Ferizaj	Nuk ka rubrikë		
34	Viti	<u>PO</u>	JO	JO
35	Partesh	Nuk ka rubrikë		
36	Hani i Elezit	Nuk ka rubrikë		
37	Kllokot	Nuk ka rubrikë		
38	Ranillug	Nuk ka rubrikë		

Plani i zbatimeve të Rekomandimeve Vjetore të Auditorit 2020

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollat në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale;

- *Departamenti i Buxhetit që nga viti fiskal 2021 kërkon nga Organizatat Buxhetore (OB) që me rastin e propozimit të projekteve të reja kapitale në procesin buxhetor, të jenë në përputhje me UA për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale. Këtij aspekti do t'i kushtohet kujdes i veçantë në dëgjimet buxhetore për buxhetin 2022. Gjithashtu, në vazhdimësi do të kërkohet nga OB-të zbatimi i rregullave me qëllim të eliminimit të keq klasifikimit.*
- *Planifikimit sa më të saktë të rrjedhës së parasë me dinamikën e shpenzimit, do të mundësohet përmes aktivizimit të modulit të ri të rrjedhës së parasë, si reformë e menaxhimit të rrjedhës së parasë dhe alokimeve, sipas projektit të mbështetur nga Banka Botërore. Viti 2022 fillon zbatimi dhe rezultatet arrihen në 2023.*

MFPT të ofrojë udhëzime të qarta për organizatat buxhetore për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale që do të financohen nga huamarrjet. Miratimi i projekteve duhet të bëhet vetëm nëse ato kanë kryer të gjitha përgatitjet dhe ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar se realizimi i këtyre projekteve do të bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur.

- *Departamenti i Buxhetit do të kërkojë dhe sigurohet që përfshirja e projekteve të reja kapitale në Ligjin e Buxhetit të bëhet në përputhje me UA për kriteret përzgjedhëse të projekteve kapitale.*
- *Një mekanizëm/trupë e përberë prej strukturave të MFPT, do të koordinojë procesin dhe rekomandojë nëse një projekt i tillë mund të financohet me huamarrje.⁹*

Plani i zbatimeve të Rekomandimeve Vjetore të Auditorit 2021

Të sigurojë që planifikimi i projekteve kapitale i nënshtrohet një analize të kapaciteteve të organizatës për menaxhimin e projekteve në përputhje me planet fillestare. Kontrollet në planifikimin e projekteve dhe realizimin e buxhetit duhet të forcohen me qëllim të realizimit të projekteve me kohë dhe arritjes së objektivave. Një harmonizim i rrjedhës së parasë me planifikimin e projekteve është i domosdoshëm për të adresuar nivelet e ulëta të realizimit financiar të projekteve kapitale.

- *MFPT përmes Departamentit të Buxhetit me rastin e lëshimit të Qarkores Buxhetore dhe gjatë dëgjimeve buxhetore do të kërkojë nga OB-të që me prioritet të planifikojnë shlyerjen e obligimeve kontraktuale dhe do të sigurohen që planifikimi i projekteve të jetë në përputhje me planin fillestar, duke respektuar kriteret e projekteve kapitale në përputhje me UA në fuqi, dhe për OB-të e nivelit qendror klasifikimi i tyre të bëhet në përputhje me kategorinë e shpenzimit.*
- *Departamenti i Buxhetit me rastin e dorëzimit të projektbuxhetit nga OB-të, përmes sistemit të PIP-it kërkon nga OB-të të zbatojnë kriteret përkatëse sipas UA. Gjithashtu, projektet të cilat nuk plotësojnë kërkesat e UA **dërgohen në rezervë të OB-së fillimisht** dhe gjatë vitit fiskal i mundësohet përfshirja në buxhet nëse plotësohen kushtet.*

Kapacitetet Planifikuese/Fondet Zhvillimore:

Raporti për Vendin (Kosovën) i Komisionit Evropian nxjerr në pah se korniza **institucionale për menaxhimin e fondeve të BE-së nuk është krijuar ende. Megjithatë, strukturat për menaxhimin e programeve dhe projekteve kombëtare të zhvillimit rajonal janë në dispozicion dhe funksionale.** Kosova duhet të forcojë më tej kapacitetet dhe burimet për menaxhimin e asistencës financiare të IPA-së të BE-së. Në lidhje me kapacitetet administrative, kërkohen përpjekje të konsiderueshme për të alokuar më shumë burime njerëzore dhe për të rritur kapacitetet e tyre, veçanërisht në planifikimin dhe menaxhimin e fondeve të BE-së. Programi fokusohet në projektet **e zhvillimit lokal** dhe asistencën e ardhshme të IPA-s. Aktualisht, **nuk ka projekte të financuara nga IPA për zhvillimin rajonal.** Në fushën e monitorimit dhe vlerësimit, vazhduan aktivitetet e rregullta në fushën e programeve dhe projekteve të zhvillimit rajonal.¹⁰ Për më tepër, IPA 3 (2021-2027), nuk do të ketë alokime financiare të fiksuara për vendet, por bazohen në kapacitetet e vendeve për të kryer reformat e nevojshme për integrimin evropian si dhe në maturimin e projekteve me të cilat

⁹ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F25B154-2116-4D2D-96A4-25691600EA9D.pdf>

¹⁰ Raporti për Vendin i Komisionit Evropian 2022

aplikojnë vendet e rajonit.¹¹ Referuar raportit të MAPL, komunat kanë arritur t'i përmbushin 60% të obligimeve që burojnë nga Agjenda Evropiane, që bien nën përgjegjësinë e implementimit të qeverisjes lokale¹².

Strategjia për Vetëqeverisje Lokale (2016-2026) thekson se kompetenca profesionale dhe menaxhuese e ulët e burimeve njerëzore, sistematizimi joadekuat i nëpunësve të administratës, politizimi i administratës, vlerësimi joprofesional i performancës, mungesa e llogaridhënies dhe mbingarkesa e administratës, ka prodhuar funksionim joefektiv dhe joefikas të sistemit¹³. Këtë e konstaton edhe raporti i progresit, ku ndër të tjera theksohet se pushteteve lokale u janë dhënë më shumë kompetenca edhe pse burimet e tyre njerëzore dhe financiare shpesh janë të pamjaftueshme.¹⁴ Në kuadër të masave për **ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, njëzetedy (22) komuna kanë hartuar programin e trajnimeve**, ndërsa në **pesëmbëdhjetë (15) komuna nuk është hartuar** programi i trajnimeve për periudhën raportuese. Lidhur me konsolidimin e mëtejshëm të qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural në **njëzetetë (23) komuna janë të funksionalizuara qendrat informative**, ndërsa në **katërmëdhjetë (14) komuna** ende nuk janë funksionalizuar.

Përderisa, sa i përket të dhënave lidhur me funksionimin e ekipeve/zyrave të aplikimit në projekte, referuar të dhënave të siguruara nga Zyrat për Informim, del se asnjëra nga njëzetetë (28) komunat që janë siguruar të dhëna, komunat nuk kanë të themeluara apo funksionale si të veçanta këto ekipe/zyra. Një **(1) komunë** - Gjakova ka vendosur **themelimin me ndryshim të statutit**, ndërkaq një **(1) komunë** - Mitrovica e Jugut është ka deklaruar se **është në proces**, por pa specifikuar formën. Përderisa, një **(1) Komunë** - Gjilani aktualisht **nuk e ka funksionale**.

Në shumicën prej komunave, kjo detyrë ushtrohet nga zyrtarë komunalë, brenda drejtorive, apo edhe Zyrës së Kryetarit.

Tabela 2. sipas komunës, statusit aktual, ushtrimit të funksionit dhe stafit

Nr.	Komuna	Statusi	Organizimi aktual/kush ushtron këtë funksion	Stafi
1	Deçan	JO	Drejtoria e Urbanizmit	4
2	Dragash	JO	Zyra e Urbanizmit	
3	Ferizaj	JO	Zëdhënësi i Komunës	1
4	Fushë-Kosovë	JO		
5	Gjakovë	JO	Në proces të ndryshimit të statutit	
6	Gjilan	PO	Zyra e Prokurimit (jo funksionale)	1
7	Glllogoc	JO		

¹¹ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-01/C_2021_8914_F1_ANNEX_EN_V5_P1_1462290.PDF

¹² Raporti i Përmbushjes së Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane (janar-dhjetor) 2022

¹³ Po aty

¹⁴ Raporti i Progresit 2019, faqe 10

8	Hani i Elezit	JO	Urbanizmit dhe Kadastrit	1
9	Istog	JO	Zyrtar për Zhvillim Ekonomik	1
10	Junik	JO	Urbanizmit dhe Kadastrit	
11	Kaçanik	JO	Urbanizmit/Zhvillimi Ekonomik	
12	Kamenicë	PO	Zyra e Kryetarit	3
13	Klinë	PO	Zyra e Kryetarit	7
14	Leposaviq			
15	Lipjan	JO	Zyra e Urbanizmit	1
16	Malishevë	JO	Drejtoria e Urbanizmit	4
17	Mamushë	JO	Drejtoria e Shërbimeve Publike	
18	Mitrovicë e Jugut	JO	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik (në proces të themelimit)	
19	Novobërdë			
20	Obiliq	JO	Zyra e Kryetarit	3
21	Pejë	JO	Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike	8
22	Podujevë	JO	Drejtoria e Urbanizmit	1
23	Prishtinë	JO		
24	Prizren	JO	Kontraktim	
25	Rahovec	JO	Agjencia për Zhvillim Rajonal	2
26	Shtërpcë			
27	Shtime	JO	Drejtoria e Urbanizmit	3
28	Skenderaj	JO	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	
29	Suharekë	PO	Zyra e Kryetarit	3
30	Viti	PO	Zyra e Kryetarit	4
31	Vushtrri	PO	Zyra e Kryetarit	1
32	Zubin Potok			
33	Zveçan			
34	Graçanicë			
35	Klllokot			
36	Mitrovicë e Veriut			
37	Partesh			
38	Ranillug			

Ndërkaq, referuar Raportit të Institutit GAP – Zbatimi i MSA në Nivelin Lokal, dalin këto thekse ‘asnjëra nga Zyrat për Integritime Evropiane nuk kanë ndjekur ndonjë trajnim se si të aplikohet në

fondet e BE-së dedikuar Kosovës. Pamundësia për të aplikuar në këto fonde po rezulton me humbjen e mundësisë që komunat t'i realizojnë disa nga planet e tyre. Zyrat për Integritet Evropiane nuk kanë qasje në data bazën e komunës për të parë se çfarë trajnimesh po merr pjesë stafi dhe po ashtu këto zyre nuk posedojnë të dhënat në lidhje me numrin dhe natyrën e organizatave joqeveritare që funksionojnë në komunat përkatëse.¹⁵ Një nga problemet e Zyrave për Integritet Evropiane nëpër komuna është mungesa e burimeve njerëzore që do të mundësonte aplikimin dhe përfitimin e fondeve të BE-së dedikuar Kosovës. Përveç kësaj, një numër i udhëheqësve të Zyrave për Integritet Evropiane në komuna nuk e njohin gjuhën angleze e rrjedhimisht e kanë të pamundur t'u qasen direkt këtyre fondeve ose të marrin pjesë në trajnime ose prezantime ku kërkohet njohja e gjuhës angleze.¹⁶

Për të parë se sa kanë përfituar komunat nga grantet, Instituti KLGI ka nxjerrë të dhëna nga raportet financiare të publikuara nga komunat në vitin 2021 dhe 2022, duke lidhur linqet e raporteve si dhe shumatat e donacioneve. Përtej financimit të alokuar në Grantin e Performancës Komunale¹⁷, që disbursohet në bazë të rezultateve në Raportin e Performancës Komunale, nga raportet financiare 2021 dhe 2022, del se pjesën më të madhe të donacioneve në komuna, e përbëjnë donatorët e brendshëm dhe participimet (linku me të dhënat e komunave që kanë paraqitur detaje - <http://bitly.ws/Di49>).

Tabela 3. Sipas komunave, donacioneve nga raportet financiare të komunave 2021 dhe 2022¹⁸

Nr.	Komuna	Totali 2021	Totali 2022
1	Obiliq	3,000	91,000
2	Podujevë	105,069	170,687
3	Prishtinë	92,615.18	23,711.58
4	Shtime	6,965	11,191.99
5	Graçanicë	1.89	/
6	Dragash	8,000	204,771.80
7	Prizren	754,923	656,971
8	Rahovec	411,164.98	627,673.71
9	Klinë	26,212.12	46,881.31
10	Pejë	5,380.24	266,065.68
11	Junik	0	0
12	Kaçanik	21,169	8,680
13	Kamenicë	/	134,916.95

¹⁵ https://www.institutigap.org/documents/36533_ZbatimilMSAseNeNivelKomunal.pdf

¹⁶ Po aty

¹⁷ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/GPK_Raporti-i-vleresimit_2022_ENG.pdf

¹⁸ Shënime me komunat që kanë paraqitur përshkrime (<http://bitly.ws/Di49>);


14	Shtërpcë	/	/
15	Novobërdë	101,000	/
16	Glllogoc	528,437.60	504,857.96
17	Fushë-Kosovë	/	/
18	Lipjan	347,947.57	/
19	Suharekë	75,500	325,116.62
20	Malishevë	1,140.36	1,140.36
21	Mamushë	0	/
22	Deçan	/	/
23	Gjakovë	41,000	/
24	Istog	36,000	/
25	Leposaviq	/	/
26	Mitrovicë e Jugut	/	152,112.60
27	Skenderaj	238,052.92	107,195.87
28	Vushtrri	319,237.82	Nuk hapet linku
29	Zubin Potok	/	/
30	Zveçan	/	/
31	Mitrovicë e Veriut	/	/
32	Gjilan	689,984.99	220,358.57
33	Ferizaj	64.93,000	357.33,000
34	Viti	5,311.50	/
35	Partesh	/	/
36	Hani i Elezit	66,383.82	106,048
37	Klllokot	/	/
38	Ranillug	/	/

Obligimet e Komunave në Procesin e Konsultimit Publik

Referuar Udhëzimit Administrativë 06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komunave, në nenin 6, pika 1, theksohet 'Komuna është e obliguar të ofrojë konsultimin publik për të gjitha dokumentet e politikave lokale si në vijim, ndërsa pikat 1.2. Projekt-buxhetin e komunës për vitin vijues, si dhe rishikimin buxhetor, 1.3. korniza afatmesme buxhetore për tri vitet e ardhshme. Po ashtu, përcaktohen edhe tri fazat e konsultimit publik: 1.1. Planifikimi i konsultimeve; 1.2. Mbajtja e konsultimeve; 1.3. Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre në organet përgjegjëse. Përderisa, në nenin 20 përcaktohet mbikëqyrja e procesit të konsultimit dhe përgjegjësitë e kryetarit dhe kuvendit: 'Kryetari komunës siguron që projekt propozimet e dorëzuara për aprovim në Kuvendin e Komunës i përmbushin standardet minimale

për procesin e konsultimit publik.’ Ndërkaq, ‘Kuvendi i komunës refuzon aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur nuk janë përmbushur standardet minimale të konsultimit publik sipas kritereve të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Bazuar në të dhënat nga raporti për vlerësimin e transparencës për periudhën raportuese, rezulton se tridhjetenjë (31) komuna kanë publikuar njoftime për takime buxhetore, ndërsa 7 komuna nuk kanë publikuar njoftime siç është (Planifikimi i buxhetit dhe KAB-it). Në formë tabelore, është paraqitur numri i komunave që kanë publikuar takimet/ diskutimet janar- dhjetor



Referuar tabelës së konsultimeve publike për proceset buxhetore del se, vetëm tri (3) komuna kanë vendosur buxhetin për platformën e konsultimit publik, ndërkaq një (1) ka vendosur qarkoren dhe një (1) vetëm njoftimin. Njëzet (20) komuna kanë publikuar raportet nga konsultimet e dëgjimeve buxhetore, ndërkaq vetëm dhjetë (10) komuna kanë publikuar raportin me komente (pranohet/pjesërisht/refuzohet), një (1) komunë ka paraqitur komentet pjesërisht.

Tabela 4. Sipas komunave, konsultimeve publike për proceset buxhetore;

Nr.	Komuna	E-KONSULTIMET	RAPORTI	KOMENTET
1	Obiliq	JO	PO	JO
2	Podujevë	JO	PO	JO
3	Prishtinë	JO	PO	JO
4	Shtime	JO	JO	JO
5	Graçanicë	JO	/	/
6	Dragash	JO	/	/
7	Prizren	JO	PO	PO

¹⁹ https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F04%2FRAPORTI-PER-VLERESIMIN-E-TRANSPARENCES-03.04.2023-_Shq_-LEKTORUAR.docx&wdOrigin=BROWSELINK

8	Rahovec	PO	PO	PO
9	Klinë	JO	PO	PO
10	Pejë	PO	PO	PO
11	Junik	Qarkorja Buxhetore	PO	JO
12	Kaçanik	PO	PO	PO
13	Kamenicë	JO	PO	PO
14	Shtërpcë	/	/	/
15	Novobërdë	JO	/	/
16	Glllogoc	JO	PO	JO
17	Fushë-Kosovë	JO	JO	JO
18	Lipjan	JO	PO	Pjesërisht
19	Suharekë	PO	PO	PO
20	Malishevë	Njoftimet	JO	JO
21	Mamushë	JO	JO	JO
22	Deçan	JO	PO	JO
23	Gjakovë	JO	PO	PO
24	Istog	JO	JO	JO
25	Leposaviq	JO	JO	JO
26	Mitrovicë e Jugut	JO	PO	JO
27	Skenderaj	JO	PO	JO
28	Vushtrri	JO	JO	JO
29	Zubin Potok	JO	JO	JO
30	Zveçan	JO	JO	JO
31	Mitrovicë e Veriut	JO	JO	JO
32	Gjilan	JO	PO	JO
33	Ferizaj	JO	PO	PO
34	Viti	JO	JO	JO
35	Partesh	JO	JO	JO
36	Hani i Elezit	JO	PO	PO
37	Klllokot	JO	JO	JO
38	Ranillug	JO	JO	JO


Tabela 5. Sipas komunave, numrit të dëgjimeve buxhetore, llojit/targetit dhe numrit të pjesëmarrësve;

Nr.	Komunat	Numri i dëgjimeve	Lloji/Targeti	Numri i pjesëmarrësve	
				Gra (%)	Burra (%)
1.	Obiliq	<u>2</u>	Të përgjithshme;	33 (45.20%)	40 (54.80%)
2.	Podujevë	<u>6</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 4 dëgjime; • Institucionet/Sektorët: Kulturë, Bujqësi • Fokus Grupe: Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor; 	E pa specifikuar	
3.	Prishtinë	<u>5</u>	Të përgjithshme;	31 (26.27%)	87 (73.73%)
4.	Shtime	<u>9 (njoftimi)</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 5 dëgjime; • Fokus Grupe: Gratë, Bizneset, Klubet Sportive, OSHC-të; • Tjera: Subjektet Politike; 	-	-
5.	Prizren	<u>10</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendrat/Fshatrat: 7 dëgjime; • Fokus Grupe: Gratë; OSHC-të; 	25 (10.55%)	212 (89.45%)
6.	Rahovec	<u>1</u>	I përgjithshëm	11 (32.35%)	23 (67.64%)
7.	Klinë	<u>4</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 4 dëgjime; 	E pa specifikuar	
8.	Pejë	<u>4</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 2 dëgjime • Fokus Grupe: grupet e interesit, klubet sportive 	72 (34.95%)	134 (65.05%)
9.	Junik	<u>2</u>	Të përgjithshme	24 (53.33%)	21 (46.66%)
10.	Kaçanik	<u>10</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 2 dëgjime • Institucionet/Sektorët: Shëndetësi; • Fokus Grupe: klubet sportive, shoqëritë kulturore-artistike, fermerët, grupet jo formale artistike, bizneset, të rinjtë, OSHC-të; 	E pa specifikuar	
11.	Kamenicë	<u>20</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendrat/Fshatrat: 18 dëgjime; • Fokus Grupe: Grupi i grave, HANDIKOS, Kryqi i Kuq; 	14 (3.97%)	338 (96.03%)
12.	Glllogoc	<u>7</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendrat/Fshatrat: 6 dëgjime; • Fokus Grupe: Shoqatat e biznesit, OSHC dhe shoqëria civile, shoqatat e grave; 	105 (38.46%)	168 (61.54%)
13.	Lipjan	<u>9</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: 8 dëgjime; • Institucionet/Sektorët: Kuvendi Komunal, Komiteti për Politikë e Financa, Komiteti për Komunitete dhe komitetet tjera; 	35 (24.64%)	107 (75.36%)

			<ul style="list-style-type: none"> • Fokus Grupe: <i>Gratë dhe Shoqatat e Gruas, Organizatat e Shoqërisë Civile, Shoqatat e të rinjve, Klubet Sportive, Personat dhe Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara, Fermerët;</i> 		
14.	Suharekë	<u>5</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>5 dëgjime;</i> 	11 (7.97%)	127 (92.03%)
15.	Malishevë	4 (vetëm njoftimi)	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>1 dëgjim (kryetarët e këshillave lokalë);</i> • Institucionet/Sektorët: <i>Arsim, Shëndetësi;</i> • Fokus Grupe: <i>Fermerët;</i> 	E pa specifikuar	
16.	Deçan	<u>5</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>2 dëgjime (kryetarët e këshillave lokalë); të përgjithshëm;</i> • Fokus Grupe: <i>krijuesit letrare, artist skenik dhe muzikore, sportist; gratë; OSHC-të;</i> 	52 (32.10%)	110 (67.90%)
17.	Gjakovë	<u>10</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>9 dëgjime;</i> • Fokus Grupe: <i>Shoqëria Civile, përfaqësuesit e të gjitha OJQ-ve dhe Grupet e interesit;</i> 	44 (29.13%)	107 (70.87%)
18.	Mitrovicë e Jugut	<u>8</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>5 dëgjime (kryetarët e këshillave lokalë);</i> • Institucionet/Sektorët: <i>Arsim, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;</i> • Fokus Grupe: <i>Sfera e kulturës, rinisë dhe sportit;</i> 	E pa specifikuar	
19.	Vushtrri	8	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>6 dëgjime</i> • Fokus Grupe: <i>Sportistët, rinia dhe komunitetin artistik; Gratë;</i> 	E pa specifikuar	
20.	Gjilan	<u>12</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>2 dëgjime;</i> • Institucionet/Sektorët: <i>Arsim, Shëndetësi; Kultura Rinia dhe Sporti;</i> • Fokus Grupe: <i>Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinorë; të rinjtë; pensionistët; HANDIKOS; fermerët dhe bizneset; komunitetet pakicë;</i> 	E pa specifikuar	
21.	Ferizaj	<u>8</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>8 dëgjime;</i> 	2 (1.98)	99 (98.02%)
22.	Hani i Elezit	<u>7</u>	<ul style="list-style-type: none"> • Qendra/Fshatra: <i>5 dëgjime;</i> • Fokus Grupe: <i>Gratë, HANDIKOS;</i> 	E pa specifikuar	

Referuar tabelës së komunave sipas numrit të dëgjimeve buxhetore, llojit/targetit dhe numrit të pjesëmarrësve, del se nga njëzet e dy (22) që kanë paraqitur informacione për konsultime, dy (2) prej tyre kanë pasur vetëm njoftime. Nga njëzet **(20) raportet e paraqitura**, katër **(4) komuna** kanë mbajtur dëgjime buxhetore të **përgjithshme**, gjashtë komuna **(6)** kanë mbajtur **tri (3)** targete/lloje të dëgjimeve (zona/fshatra, institucione/sectorë dhe fokus grupe) - një (1) komunë prej tyre ka mbajtur takim me (subjektet politike), **tetë (8) komuna** kanë mbajtur dëgjime buxhetore me nga **dy (2)** target/lloje (qendra/fshatra).

Sa i përket transparencës buxhetore, komunat në përgjithësi qëndrojnë mirë. Nga 38 komuna, 31 ose 82% e komunave kanë publikuar planin e buxhetit, ndërsa 7 komuna ose 18 % prej tyre nuk kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2022. Komunat të cilat nuk kanë publikuar planin e buxhetit janë: (Novobërda, Parteshi, Ranillugu, Zubin Potoku, Zveçani, Leposaviqi dhe Mitrovica e Veriut)²⁰.



Referuar Nenit 61, shqyrtimi i Buxhetit Komunal nga Kuvendi Komunal, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, në pikën 61.1 theksohet se ‘pas miratimit të propozim-Buxhetit Komunal nga Kryetari i Komunës, deri më 1 shtator të vitit përkatës fiskal, duhet t’ia dorëzojë këto dokumente Kuvendit Komunal.’ Ndërkaq, në pikën 61.2 ‘pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime publike në përputhje me aktet e aplikueshme ligjore të komunës. Pas këtyre dëgjimeve, Kuvendi Komunal deri në datën e përcaktuar në paragrafin 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet të shqyrtojë, ndryshojë siç e shihet të nevojshme ose të arsyeshme si dhe të miratojë dhe t’ia dorëzojë Ministrisë propozim-buxhetin komunal.’

Një komponentë e rëndësishme është edhe Buxhetimi Gjiner, referuar Ligjit për Barazi Gjimore, tek përkufizimet theksohet se ‘Buxhetimi Gjiner - është zbatimi i integritetit gjiner në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve’. Përderisa, në nenin

²⁰ https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fmapl.rks-gov.net%2Fwp-content%2Fuploads%2F2023%2F04%2FRAPORTI-PER-VLERESIMIN-E-TRANSPARENCES-03.04.2023-_Shq_-LEKTORUAR.docx&wdOrigin=BROWSELINK

5, masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore vendos në pah 'përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve. Përkundër që legjislacioni në fuqi në Kosovë kërkon përfshirjen e perspektivës gjinore në buxhetim, si dhe ofron manuale se si të bëhet vlerësimi gjinor i politikave të ndryshme, dokumentet strategjike, sikurse Projektbuxheti 2023, nuk përfshijnë vlerësim gjinor të buxhetit. Përfshi këtu një vlerësim gjinor të buxhetit apo një analizë që tregon se si ndikohen gratë dhe burrat nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i çerdheve, ndërtimi i stadiumeve, ndriçimi i trotuareve, etj. Pikërisht tek pjesa e investimeve kapitale, të dhënat tregojnë se për disa nga projektet me peshën më të madhe në buxhet, projektet e përzgjedhura nuk kanë ngërthyer edhe vlerësime të ndikimit gjinor.²¹

Edhe pse Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përkatësisht neni 61, pika 61.2 e këtij ligji, obligon kuvendet komunale që pas pranimi të projekt buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbajë dëgjime buxhetore. Referuar raporteve të paraqitura, në vetëm pesë (5) procese ka udhëhequr Kryesuesi i Kuvendit, apo Zyra e Kuvendit Komunal, në pesë (5) raste takimi është udhëhequr nga Drejtorët e Financave, në gjashtë (6) raste grupi punues, në një (1) rast zyrtari për konsultim dhe në tri (3) raste nuk ka detaje. Por, duhet theksuar se në shumicën prej rasteve kur ka pasur grup punues, nuk ka përfshirje nga anëtarët e Kuvendeve Komunale.

Në asnjë prej njëzetë (20) komunave që kanë paraqitur raporte, nuk ka ndonjë praktikë ku prezantohen ndarje specifike sipas zonave/fshatrave, apo edhe në bazë të target grupeve. Po ashtu, nuk ka raste kur në proceset e dëgjimeve, bashkëngjitet listë me kërkesa të protokolluara në zyrat pritëse komunale.

Nga tridhjetenjë (31) komuna që kanë publikimet e buxheteve komunale, del se vetëm pesë (5) kanë bashkëngjitur shtojcën e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor (BPGj). Po ashtu, edhe tek paraqitja në detaje, e investimeve kapitale, del se vetëm njëzet e tri (23) komuna, kanë shënime, për lagjen, fshatin apo edhe shkollën ku do të kryhen investimet publike.

Në njëmbëdhjetë (11) komuna janë adresuar çështje/probleme të ndër-varura si: *trafo-rrjet elektrik, ujësjellës-kanalizim, menaxhim i shtatoreve dhe varrezave, trotuare në rrugë magjistrale, mbikalimet-siguria në hekurudha, pronat e agjencive/nivelit qendror, afati i legalizimit.*

²¹ [https://www.institutigap.org/documents/32258_projektbuxheti_2023_SHQ\(f\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/32258_projektbuxheti_2023_SHQ(f).pdf)

TABELA 6. SIPAS KOMUNAVE, DATËS SË THIRRJES SË MBLEDHJES, UDHËHEQJES, PREZANTIMIT TË DETAJEVE NË DISKUTIME, DETAJET E INVESTIMEVE SI DHE SHTOJCA E BPGJ

NR.	Komuna	Thirrja për seancë	Zhvillimi dhe udhëheqja e procesit të dëgjimeve buxhetore	Tabela e kërkesave në sistem e qytetarëve;	Detajet Investime Kapitale në buxhet;	BPGJ
1.	Obiliq	19.09.2022	Kryesuesja e Kuvendit	JO	PO	JO
2.	Podujevë	20.09.2022	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	JO	PO	PO
3.	Prishtinë	06.09.2022	Zyrtari për konsultim;	JO	PO	JO
4.	Shtime	20.09.2022	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
5.	Graçanicë		Nuk ka të dhëna;		JO	JO
6.	Dragash	12.09.2022	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
7.	Prizren	13.09.2022	Grupi Punues;	JO	PO	JO
8.	Rahovec	15.09.2022	Kryesuesi i Kuvendit;	JO	PO	PO
9.	Klinë	13.09.2022	Grupi Punues;	JO	PO	JO
10.	Pejë	16.09.2022	Drejtori për Buxhet dhe KPF	JO	PO	JO
11.	Junik	20.09.2022	Pa detaje;	JO	PO	JO
12.	Kaçanik	21.09.2022	Drejtoria e Financave;	JO	PO	JO
13.	Kamenicë	19.09.2022	Grupi Punues;	JO	PO	JO
14.	Shtërpçë	16.05.2022	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
15.	Novobërdë	23.09.2022	Nuk ka të dhëna;		JO	JO
16.	Glllogoc	24.08.2022	Zyra e Kuvendit Komunal	JO	PO	PO
17.	Fushë-Kosovë	/	Nuk ka të dhëna		JO	JO
18.	Lipjan	15.09.2022	Drejtoria për Buxhet dhe Financa;	JO	PO	JO
19.	Suharekë	16.09.2022	Grupi Punues;	JO	JO	JO
20.	Malishevë	31.08.2022	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
21.	Mamushë	/	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
22.	Deçan	19.09.2022	Kryesuesi i Kuvendit;	JO	JO	JO
23.	Gjakovë	21.09.2022	Grupi punues;	JO	PO	PO
24.	Istog	/	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
25.	Leposaviq	/	Nuk ka të dhëna;			
26.	Mitrovicë e Jugut	15.09.2022	Drejtoria për Buxhet dhe Financa;	JO	PO	PO
27.	Skenderaj	19.09.2022	Nuk ka të dhëna;		JO	JO
28.	Vushtrri	31.08.2022	Pa detaje;		JO	JO
29.	Zubin Potok	/	Nuk ka të dhëna;			
30.	Zveçan	/	Nuk ka të dhëna;			
31.	Mitrovicë e Veriut	/	Nuk ka të dhëna;			
32.	Gjilan	/	Kryesuesi i Kuvendit Komunal;	JO	JO	JO
33.	Ferizaj	16.09.2022	Grupi Punues;	JO	PO	JO
34.	Viti	/	Nuk ka të dhëna;		PO	JO
35.	Partesh	/	Nuk ka të dhëna;			
36.	Hani i Elezit	22.09.2022	Pa detaje;	JO		
37.	Klllokot	21.09.2022	Nuk ka të dhëna;			
38.	Ranillug	/	Nuk ka të dhëna;		JO	JO

Tabela 7. Sipas fushave dhe prioriteteve nga dëgjimet buxhetore

TAKIMET E PËRGJITHSHME	
Investimet publike /infrastrukturë	Asfaltim i rrugëve; ndërtimi i ujësjellësit; ndriçim publik; shtrimi/rregullimi i trotuareve; rregullimi i varrezave; vendosja e pengesave në rrugë; hapësira të komunitetit; rregullimi i këndit të lojërave për fëmijë; ndërtim i parqeve; sigurimi i uniformave në sektorin e shëndetësisë; renovim i shkollave; mbjellja e drunjve, rregullimi i deponisë së mbeturinave inerte; ndërtimi i stacionit të autobusëve.
Mirëmbajtje	Sistemi i ujitjes; thurja e varrezave dhe rregullimi i tyre; mirëmbajtja e trotuareve; mirëmbajtja e rrugëve; parandalimin e shkatërrimit të pyjeve; rregullimi i ndriçimit publik; pastrimi i rrugëve me ujë; trajtimi i shtretërve të lumenjve; dezinfektimi; deratizimi dhe dezinfektimi.
Shërbime	Sigurimi i transportit publik; legalizimi i pronave; vendosja e barrierave për kufizimin e shpejtësisë; organizimi i kurseve të ndryshme për gratë; lëshimi i 'petty cash'.
Subvencione	Mbështetje financiare (bletari, ushqime tradicionale); përkrahja e grave; mbështetje e qendrës rinore.
Tjera	Publikimi i raporteve të drejtorive në web-faqe; buxhet më i madh për Drejtorinë e Shëndetësisë (Prishtinë); hartimi i planit rregullues për ndërtimin e infrastrukturës; ruajtja e trashëgimisë kulturore; emërtimi i rrugëve.
ZONALE/FSHATRA	
Investimet publike /infrastrukturë	Asfaltimi i rrugëve; ndriçim publik; kanalizim; trotuare; renovim i shkollave; ndërtimi i sallave sportive; ndërtimi i ujësjellësit; shtylla elektrike; kubëzim; rregullimi i shtretërve të lumenjve; parqe; kënde për fëmijë; ndërtimi i urave; çerdhe; ambulanca të reja; lapidare për dëshmorë; kontejnerë për mbeturina; rrjeti elektrik; park për të moshuar; ulëse në çdo pjesë të fshatit; ndërtimi i mureve mbrojtëse; instalimi i kamerave; ndërtimi i rrugës së turizmit malor; shtëpi e kulturës në fshat.
Mirëmbajtje	Pastrimi i lumenjve; menaxhimi i mbeturinave; mirëmbajtja e varrezave; mirëmbajtja e rrugëve; largimi i pengesave në rrugë; uji i pijes; rregullimi i rrethojave të shkollës; mirëmbajtja e parqeve; mirëmbajtja e hapësirave shkollore; rrënimi i shtëpive të vjetra; rrënimi i garazheve; rivarrimi; prerja e plepave.
Shërbime	Rritja e stafit mjekësor; mungesa e shtypjes së ujit, rryma e dobët; transport publik; funksionalizimi i ambulancave; pastrimi i lumenjve; tabela informuese në fshatra; hapja e rrugëve për bjeshkë; funksionalizimi i objektit të veterinarisë; riparimi i kamerave; inspektimi; komision për formimin e rrugëve.
Subvencione	Mbulimi i pagesave të udhëtimit të nxënësve; subvencion për sektorin e blegtorisë; subvencionim për pajisje bujqësore (makineri); mbështetje financiare për forumin e grave; për nënat lehona.
Tjera	Qendrat e strehimit për qentë endacakë; përkujdesja për fëmijët me kushte të rënda ekonomike; lehtësimi i procedurave për leje-ndërtim; buxheti të shpërndahet proporcionalisht në të gjithë fshatrat; buxhet vetanake për çdo shkollë; zgjedhja e kryetarëve të fshatrave.
INSTITUCIONET/SEKTORËT	
Investimet publike /infrastrukturë	Asfaltimi i rrugëve; ndriçim publik; ndërtimi i sallave sportive; ndërtimi i trotuareve; blerja e automjetit për shërbime të institucioneve publike; renovimi i shkollave; ndërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës.
Mirëmbajtje	Rregullimi i hapësirave publike; rregullimi i ulëseve të sallave; materiale higjienike.

Shërbime	Mungesë e stafit mjekësor; përmirësimi i sistemit të ngrohjes; mungesa e laboratorëve.
Subvencione	-
Tjera	Ikja e mjekëve; rritja e buxhetit për shëndetësinë; rritja e buxhetit për mallra, shërbime dhe investime kapitale; monitorim i punës së ambulancave; vazhdimi i projekteve të planifikuara me parë; mbipopullimi i fshatrave.
FOKUS GRUPE	
Investimet publike /infrastrukturë	Ndërtimi i një kopshti për fëmijë; 0 trotuare të veçanta për persona me aftësi të kufizuara; çerdhe publike; rregullimi i infrastrukturës rrugore; ashensor, rregullimi i objekteve shkollore; trotuare; kanalizim; plan rreth mbikalimeve; salla sportive; tualete publike; qendër rinore; rregullim i varrezave; krijimi i qendrës për ndërmarrësi, karrierë dhe inovacion.
Mirëmbajtje	Trajtimi i ujërave të zeza; renovimi i objekteve; probleme me ujin e pijes; mbjellja e drunjve.
Shërbime	Transport publik; përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave; barna më të lira; barnatore vetëm për pensionistët; sigurimi i transportit për personat me autizëm; rritja e stafit mjekësor; sigurimi i mjeteve për shëndetësi; ujësjellës.
Subvencione	Përkrahja e grave përmes trajnimeve dhe panairëve; përkrahja e grave me mjete bujqësore; mjete financiare për OJQ; fond emergjent për trajtimin e rasteve të dhunës në familje; mbështetje e klubeve sportive për personat me aftësi të kufizuar, subvencionimi i sindikatës HENDIKOS për rehabilitim; mjete buxhetore për organizata e rinisë.
Tjera	Organizimi i panairëve; ndërtimi i sallave për trajnime të ndryshme; përkrahja e grave dhe vajzave të reja në fushën e ndërmarrësisë; identifikimi i ndotësve të ujërave; më shumë aktivitete për të rinjtë; organizimi i punëtorive; përgatitja e strategjisë për barazi gjinore; të përfundohen projektet e mbetura në gjysmë.

Tabela 8. Adresimet e kresave/çështjeve të ndër-varura²²

NR.	Komuna	Prioritetet	Referimi i Problemeve të ndër-varura
1	Obiliq	Investime publike/infrastrukturë: (Investime në rrjetin elektrik; Zgjerim të Ujësjellësit	Të bëhet kërkesë në komunë apo Ibër Lepenc; Këtë vit kemi marrëveshje me Ibër Lepencin, të paguhet çdo ari tokë që është ujitur, kjo për tri vitet e ardhshme; Sa i përket rregullimit të trafave dhe energjisë elektrike, vazhdimisht komuna e Obiliqit po tenton të punojë në këtë drejtim.
2	Podujevë	Sjellja e ujit të pijshëm në fshat	Bashkëpunim me ujësjellësin në ndërrimin e gypave.
3	Prishtinë	Investime publike/infrastrukturë: Kanalizimi; Ujësjellësi	Kërkesat lidhur me ujësjellësin dhe kanalizimin do të shkojnë në të gjitha drejtoritë përkatëse.
4	Klinë	Kërkesë për instalimin e ujësjellësit	Për shtrim të rrjetit të ujësjellësit, komuna e Klinës do të bashkëpunojë me "Hidrodrinin" duke bashkë-financuar projekte të ndryshme.
5	Pejë	Elektrifikimi i rrjetit energjetik	Të pa adresuara/Jashtë kompetencave komunale.
6	Kamenicë	Intervenim në shtyllat elektrike	Jashtë kompetencave komunale.
7	Kaçanik	Rregullim të rrjetit të rrymës, për arsye të vjetërsimit të shtyllave; Rritja e kapaciteteve të ujësjellësit	Rehabilitimi i rrjetit të energjisë elektrike është përgjegjësi e KEDS/KESCO. Rritja e kapaciteteve të ujit do të shqyrtohet në koordinim me KRU "Bifurkacioni".
8	Glllogoc	Investime publike/infrastrukturë: Asfaltimi i rrugëve, furnizimi me ujë të pijes; Kanalizim; Ndriçim publik; Rregullimi i varrezave; Rregullimi i trotuarit. Mirëmbajtje: Shërbime:	Legalizimi është nën përkujdesjen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sa i përket parkingut, ajo është pronë e ministrisë, por besoj që së bashku me ministrinë do ta rregullojmë. Sa i përket shtyllave të betonit të energjisë elektrike, duhet të bëni kërkesë në KEDS.
9	Suharekë	Investime publike/infrastrukturë: Ndërtim i trotuarit; Emërtimi i rrugëve; Kërkesë për ujësjellës; Ndërtimi i një këndi të lojërave Mirëmbajtje Shërbime	Kërkesa për ujësjellës duhet t'i drejtohet "Hidro-Regjionit", sepse është kompetencë e tyre. Për ndërtimin e trafos do t'i bëjmë kërkesë KEDS-it. Mirëmbajta e kanalizimeve është kompetencë e "Hidro-Regjionit".
10	Gjakovë	Investime publike/infrastrukturë: Ndërtimi i kanalizimit; Ndërtimi i rrugëve; Rregullimi i deponisë së mbeturinave inerte; Ndriçimi publik	Lidhur me lapidarin e dëshmorit, kërkesa duhet të drejtohet tek Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, për shkak që këto 11 objekte janë kompetencë e kësaj agjencie.
11	Hani i Elezit	Investime publike/infrastrukturë: Ndërtimi i shkallëve tek varrezat për shkak të pjerrtësisë së vendit; Rregullimi i këndit të lojërave përballë komunës	Mbikalimi është kompetencë e "Infrakosit" dhe "Trainkosit" dhe do të realizohet nga ato; Ndërtimi i stacionit të autobusëve nuk është kompetencë e komunës; Kjo kërkesë është kompetencë e KEDS-it; Kjo është kërkesë e kompanisë NPL "Pastrimi".

²² Linku me detaje (<http://bitly.ws/DsGo>)

Konkluzione:

- Në ueb faqet e komunave, qasja për materialet e punës së Kuvendeve Komunale, mbetet e kaotike, nuk ka ndonjë strukturë uniforme, përderisa edhe tek komnatat që publikojnë materialet e punës (propozim buxhetet), nuk ekziston ndonjë format i standardizuar i publikimi;
- Përkundër që Udhëzimi Administrativ për Kriteret Përzgjedhëse të Investimeve Kapitale, nxjerr obligime të qarta për komnatat dhe për dy vite radhazi (2020 dhe 2021) vendoset në thekset e auditorit, shumica nuk përmbushin obligimet;
- Mangësi e theksuar del edhe tek procesi i programimit si rrjedhojë e problemeve që dalin nga identifikimi i qartë i nevojave, analiza ndërthurëse si dhe ndjekja e strategjive zhvillimore komunale dhe nacionale; për rrjedhojë ndodhë fragmentimi i politikave dhe investimeve si dhe humbet potenciali për aplikime në fonde zhvillimore rajonale dhe IPA;
- Procesi i konsultimit të buxheteve komunale, ka mangësi të theksuara nisur nga mbledhja e kërkesave, trajtimin, adresimin dhe deri tek publikimi; për këtë raportin i auditorit thekson se komnatat e audituara ende nuk kishin procese standarde të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimin e tyre dhe prioritetizimin e nevojave për investim;
- Ndërkaq, sa i përket shtrirjes së diskutimeve në qendra/fshatra, del se mbetet sfiduese, për rrjedhojë mungon edhe një shpërndarje e drejtë dhe e barabartë e investimeve publike. Po ashtu, edhe tek përfshirja e publikut, në veçanti grupeve të veçanta, dalin mangësi të theksuara, si rrjedhojë e kësaj shpesh investimet publike, nuk marrin parasysh ndjeshmërinë ndaj tyre, në veçanti grave, personave me aftësi të kufizuara, minoriteteve dhe grupeve të cënueshme;
- Reflektohen përqindje e ulët e pjesëmarrjes së grave në dëgjime buxhetore;
- Ekzistojnë paqartësi dhe kahe të kundërta në zbatimin e mandateve për proceset buxhetore komunale, përderisa ekzekutivi nuk ka krijuar procese standarde të pranimit, shqyrtimit dhe prioritetizimit të nevojave për investime, por që kryen detyrat e Kuvendeve Komunale për dëgjime buxhetore; përderisa anëtarët e Kuvendeve Komunale, nuk zbatojnë mandatin mbikëqyrës për proceset e konsultimeve dhe prioritetizimit të investimeve;
- Një problem sistematik, që për rrjedhojë rritë presionin në qendër, është mungesa e një hartëzimi të qartë të rrugës së kërkesës së qytetarëve, nisur nga kërkesa, analizimi, prioritetizimi, konsultimi si dhe pasqyrimi në detaje. E shtyrë edhe nga mungesa e mekanizmave të konsoliduar si këshillat lokale, komitetet konsultative dhe përfshirja e fokus grupeve, shpesh ulë nivelin e besueshmërisë në strukturën e procesit dhe shton presionin për drejtoritë dhe ekzekutivin;
- Është sfidues procesi i adresimit të problemeve të ndër-varura (*trafo-rrjet elektrik, ujësjellës-kanalizim, menaxhim i shtatoreve dhe varrezave, trotuare në rrugë magjistrale, mbikalimet-siguria në hekurudha, pronat e agjencive/nivelit qendror, afati i legalizimit*).

Rekomandime:

- Të ndërtohen forma standarde, nëpërmjet një manuali standard për proceset buxhetore, si dhe strukturë unike për publikim në ueb faqe;
- Të rritet informimi dhe të ngritën kapacitetet për prioritizimin e investimeve kapitale bazuar në shtojcën e udhëzimit administrativ;
- Kuvendet komunale të rrisin kërkesën për llogaridhënie për proceset e vlerësimit dhe poentimit sipas kriterëve;
- Të ndërtohen struktura kompakte dhe sisteme të integruara për identifikim, analizë, prioritizim, projektim të proceseve kyçe komunale, ndërlidhje me strategjitë, politikat dokumentet zhvillimore lokale dhe nacionale si dhe aplikime në nisma dhe fonde zhvillimore;
- Të ndërtohet harta e proceseve kyçe konsultative buxhetore si dhe të standardizohet procesi nga pranimi i kërkesës deri tek aprovimi dhe publikimi në platformat komunale;
- Të definohen qartë mandatet dhe funksionet në mes ekzekutivit dhe kuvendit në ushtrimin e mandateve; Të avancohet niveli profesional i prioritizimit të investimeve kapitale, nga ekzekutivi; Të ushtrohet mandati i Kuvendeve Komunale mbi përgjegjësitë dhe atributet kryesore në miratimin e buxhetit; si dhe të forcohet roli i mbikëqyrjes mbi ekzekutivin;
- Të konsolidohen mekanizmat komunalë për zgjerim të konsultimit dhe kontribute profesionale (këshillat lokalë, komitetet konsultative); Të ndërtohen, konsolidohen platforma dhe agjenda komunale për bashkë-dizajnim të politikave me përfshirjen e publikut si dhe fokus grupeve; Të përdoret qasje ndërthurëse në politika, procese dhe financime e çështjeve që prekin grupet e veçanta si gratë, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet dhe grupet e cenuara;
- Të shtohet fokusi tek rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset e dëgjimeve buxhetore, duke përgatitur plane të veçanta të informimit dhe përfshirjes.
- Të ullet tollovia në qendër duke shtrirë mekanizmat përfaqësues si dhe duke hapur mundësitë që dikasteret komunale të rrisin rolin programues, menaxhues dhe monitorues.
- Ndërkaq në adresimin e problemeve të ndër-varura rekomandohet të konsolidohet sistemi i komunikimit, prioritizimit dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve rajonale, qendrore, agjencive dhe nivelit qendror.



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +381 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com